

KOSOVARJA

HISTORI SUKSESI



MARIGONA
MOE



VALENTINA
NIKQI



ARGJIRA
OSMANAJ GJYLIQI





ALMA MATER EUROPÆA
SPITALI PËRGJITHSHËM
REZONANCA 2

Vizitë falas

Tek Kirurgu i Fëmijëve



Çdo të premte
Nga 14:30 deri 18:00

Shkojnë në shkollë sa për ta kaluar ditën!

Shkolla, të pëlqen a s'të pëlqen, është vendi ku do i kalosh së paku 12 vjet (nëse nuk përsërit ndonjë vit) të jetës sate. Mund të jenë vite të mërzitshme ose atraktive, varësisht prej individit. Shkolla kishte reputacion dikur, kurse sot, thënë të drejtën, nuk po merret edhe aq seriozisht.

Në këtë temë flasin disa nga nxënësit e anketuar të shkollave të mesme të Prishtinës...

GRANITA: S'KAM MOTIV TË MËSOJ!

- Nuk di pse s'kam vullnet të mësoj. Monotoni e madhe. Të paktë janë ata që sot, vërtet, mësojnë sa duhet.

Nuk di ku qëndron arsyeja, nuk e di pse po tregohemi kaq të pa interesuar për mësim?!

Unë, për vete, s'kam motiv të mësoj! Keq, a?

ETNA: NË ORËT E FUNDIT BANKAT JANË TË ZBRAZËTA!

- E di fort mirë se pa shkollim nuk ka të ardhme. Megjithatë, pak, për të mos thënë

fare, po mësoj.

Në klasën time janë vetëm dy a tre nxënës që mësojnë sa duhet, e ne, të tjerët, hajt, sa për të shkuar në shkollë...

Në orët e fundit pjesa më e madhe e bankave janë pa nxënës, të zbrazëta.

E, kjo tregon më së miri për atë se sa jemi të interesuar për mësim...

LEARTI: SHKOLLA ËSHTË PJESË E JETËS...

- Është një anketë interesante, e që, për fat të keq, shumë nga nxënësit nuk mund të flasin edhe fjalë të mira, sepse pakkush sot mëson sa duhet.

Por, unë mendoj ndryshe, sepse nuk jam preja tyre që shkojnë në shkollë sa për të marrë një diplomë.

Andaj, t'u përvishemi mësimëve, sepse shkolla është pjesë e jetës...

DETJA: MËSOJ DHE PUNOJ...

- Meqë në familje nuk i kemi punët mirë materialisht, pas mësimi punoj në një ëmbëltore, andaj kohë për të mësuar kam shumë pak.

Por, edhe shoqet e mia që i kanë punët mirë, edhe pse ato nuk punojnë pas mësimi si unë, as ato nuk janë më të mira në mësim sesa unë.

Megjithatë, te shumica e neve, nxënësve,

ka rënë interesimi për mësim. Ndoshta shkak i papunësisë së madhe!

FISNIKU: PA SHKOLLË S'KA AS PUNË

- Të kesh një vend pune sot është suksesi më i madh në jetë, sepse gjendja materiale sa vjen e po keqësohet për shumicën e qytetarëve të Kosovës. Faktori kryesor për gjendjen tonë të rëndë ekonomike është papunësia e madhe. Unë pas orëve të mësimi punoj kamerier në një kafiteri në Lagjen "Dardania" të Prishtinës, sepse nga unë presin e ëma dhe motra ime, e që është më e re se unë.

Më pëlqen puna që bëj, por nuk po më mbetet edhe aq kohë për mësim, sepse po lodhem shumë dhe në mbrëmje mezi pres të shtrihem në shtrat.

Por, edhe pa shkollë s'ka asgjë, sepse rrethi dhe shoqëria, në përgjithësi, të trajtojnë analfabet.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Nga të anketuarit tanë shihet qartë se pa shkollim nuk ka ardhmëri të duhur. Por, pakkush sot po mëson sa duhet, meqë perspektiva pas shkollimit nuk shihet askund, meqë shumë të rinj edhe pas kryerjes së studimeve sillen poshtë e lartë, meqë nuk mund të gjejnë një vend pune!

Diturie Haxhaj



A ka me i vra buka politikanët tanë?

Nëse një ditë shteti nuk do bëhet mirë, ashtu si nuk po bëhet në fakt, populli ka arsye t'i mallkojë politikanët tanë që po luajnë me popull! "Të vret buka jote", thotë një thënie popullore.

Sillen mendimet e mia përgjatë dhomës. M'u kujtua një ngjarje në një odë të fshatit Mirash të Ferizajt.

I kishte vdekur babai një moshatarit tim, që më quante dajë, por kurrë s'e kam ditur pse e kam dajë.

Babai kishte vdekur moti, e unë kisha qenë tepër i vogël të pyesja pse e kishim dajë filanin që vinte në odën tonë.

U nisa të shkoja ta vizitoja dajën dhe kur arrita atje u drejtova drejt e në odë.

Një sallon shumë i madh, që shfrytëzohej për odë burrash.

Më ulën në krye të sallonit, atje ku ndodhej përballë një plak.

Pasi mbretëroi heshtja, u hapë biseda ngushëlluese.

Plaku, meqë e kishte pranë një kujdestar interpretimi, ofroi veshin afër tij dhe kujdestari i tregoi se kush isha.

Plaku në çast u ngrit në këmbë dhe më

përqafoi shumë.

Në ato çaste u ndjeva ngushtë...

Oda ishte plot burra dhe diçka e madhe duhej të kishte ndodhur që ai u ngritë e më përqafoi.

"A i ke përngjarë babës?", më tha.

"Pak a shumë po", ia ktheva.

Dhe, pas këtij dialogu më tha se kishte qenë mik e shok i besës së babait tim, qyshkur kishin qenë ballistë në male dhe e kishin shkelur në këmbë Shqipërinë deri në Tivar.

Unë, për ta relaksuar situatën e krijuar, që te të tjerët zgjoi interesim të madh ardhja ime në odë, i thashë:

"Unë mendova se vetëm pse jam i madh me trup të bëra përshtypje e u ngrite në këmbë për mua! Por, po e tregoj një mesele: E pata gjetur një këlysh të vogël dhe e qova në shtëpi. E gënjeva babën se ishte i racës së Sharrit, bëhet kështu e

ashtu, e mbytë ujkun, e lavde të tjera për këlyshin, vetëm e vetëm që të mos ma humbte".


Ai ndërhyri duke qeshur: "Ky nuk bëhet qen i madh, biri im, sepse është pinok. Nuk na duhet qeni i vogël në oborr, sepse qenit të vogël askush nuk ia ka frikën e të madhit po".

E, edhe unë mendova pse jam i madh me trup u ngrite në këmbë për mua!"

Dhe, këtë mesele po e lidhi me politikën aktuale te ne: Shkoi tërë viti 2025 dhe pa asnjë rezultat në politikë. Përçarje sa të duash, kurse populli ditë e më shumë po sharron në skamje. Veçmas pensionistët janë bërë për lëmoshë, por as për ta s'e qanë kokën kush, madje...

Por, një gjë dihet: ishalla populli s'i mallkon politikanët tanë që po luajnë me popull se do i vret buka e vet...

S. Krivaça



www.ias-ks.com



Kush e bëri qytezën qytet?

Skenderaj, e që shtrihet në zemër të Drenicës, më nuk ndodhet në baltë si dikur kur qendra vërshohej nga uji e balta. Aty ku njerëzit dikur ecnin vetëm me çizme, tash jetohet mirë, falë urbanizimit të infrastrukturës së qytetit. Skenderaj, qytet me shëtitore të bukur e me infrastrukturë moderne, është qytet që i është kthyer besimi për jetë të mirë. Kush e bëri qytezën qytet?

Komuna e Skenderajt i ka 47 fshatra në kuadër të territorit të vet komunal. Me një

objekt të bukur komunal e me infrastrukturë moderne, me sallë të mrekullueshme asambleje që nuk e ka asnjë komunë tjetër, por edhe me pastërti ekskluzive brenda e jashtë objektit, Skenderaj është komuna që prezanton modelin e një komune institucionale shtetërore.

I kanë asfaltuar të gjitha fshatrat, sepse të gjitha ishin në baltë e kushte të mjerueshme.

Të gjitha meritat për një pamje të bukur të qytetit, të kulturës, infrastrukturës dhe rehatisë, qytetarët ia dedikojnë një njeriu të vetëm, që e quajnë njeri të popullit dhe që ka bërë shumë për popullin.

Ai është Sami Lushtaku, e që në të ardhmen në këtë qytet edhe mund t'ia ngritin një shtatore, shkaku i meritave të tij për popullin e kësaj komune.

Ç'THONË QYTETARËT?

Imeri, burrë rreth të 60-tave, pronar i një minimarketi, thotë se meritat për një përparim të madh në Skenderaj ia atribuon Sami Lushtakut.

"Kryetari Sami Lushtaku është njeriu më meritor pse sot Skenderaj është bërë qytet i bukur.

Para lufte në Skenderaj nuk kishte asgjë për t'u dalluar, ndërsa tani janë të gjitha që

i ka një qytet urban.

Është dashtë punë e madhe për ta hequr baltën nga qyteza e dikurshme, angazhim i posaçëm dhe i përkushtuar që të bëhet diçka e mirë, por është dashur edhe guxim i madh që të vendosen rregulla qytetarie në nivel qyteti.

Këtë aftësi dhe këtë guxim e ka pasur dhe e ka kryetari Sami Lushtaku, për çka ne, qytetarët, i jemi mirënjohës", thotë Imeri. Ndërkaq, Demiri, i cili veç i ka kaluar të 70-at, dridhet derisa e kujton kohën e paraluftës me atë sotmen në Skenderaj. Sot, sipas tij, të kënaqet shpirti kur i sheh të rinjtë teksa ecin shpesh nëpër shesh pas përfundimit të mësimet, por edhe në orët e mbrëmjes kur Skenderaj vezullohet nga dritat...

Sheshit ia shtonë madhështinë, pa dyshim, busti i komandantit legjendar Adem Jashari, e që pranë tij të rinj e të reja, të moshuar e të moshuara bëjnë fotografi në çdo kohë...

Sidoqoftë, se Skenderaj e ka ndërruar pamjen krejtësisht u bindëm kur në restorantin që pimë kafe, nga kati i nëntë, pamë tërë qytetin dhe shtrirjen e tij të mrekullueshme. Pamë me sytë tanë një panoramë madhështore që shtrihej gjithandej...

S. Krivaça

Ç'AMANET DO LËNË LIDERËT TANË?



*Më është krijuar përshtypja se shpejt po ikin ditët.
Ndoshta pak vetave u duket kështu apo edhe shumicës...*

Pa dyshim, ka edhe të atillë të cilëve u duket se ditët po ecin ngadalë. Ata janë në pritje të diçkafes, janë të dëshpëruar, pa vullnet... I kësaj kategorie të njerëzve është edhe një mik imi, i cili më thotë se e ka marrë malli për ditë të mira ku problemet jetojnë larg. I mungon koha e fëmijërisë kur ka fjetur qetë.

Nga kjo del se nuk është e vërtetë që njeriu ndryshon me kohën. Ai ndryshon me zhgënjimet që merr nga jeta.

Pra, njerëzit gati gjithmonë mendojnë mbrapsht: nxitojnë të përfitojnë, humbin shëndetin duke vrapuar pas parasë dhe pastaj i humbin paratë për ta rikthyer shëndetin.

Kështu, pra, e mendojnë me ankth të ardhmen dhe e lënë pas dore të tashmen. Si përfundim, jetojnë sikur kurrë nuk do të vdesin dhe vdesin sikur nuk kanë jetuar kurrë...

Aleksandri i Madh para vdekjes lë amanet:

"Varroseni trupin tim dhe mos më ndërtoni asnjë monument në varrin tim! M'i lini duart jashtë që njerëzit ta kuptojnë se ai që e fitoi botën vdiq duarthatë!"

A thua, ç'amanet do lënë liderët tanë, të cilët për pushtet e harrojnë popullin?!

E lënë popullin me probleme, me varfëri, me papunësi, në skamje...

Luajnë me nervat dhe ndjenjat e popullit që një vit nga lakmia e tyre e madhe për pushtet!

Por, ç'mërziten ata për ne?

Ata pagat e veta i marrin me rregull, e çka u ha palla për ne!

Krijojnë mjegull për t'u pasuruar më lehtë...

Por, pas çdo nate vjen edhe dita.

Pas çdo hidhërimi vjen edhe buzëqeshja.

Pas çdo lutje vjen edhe përgjigja.

Cila është përgjigja që do na japin nesër?

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Në Zvicër, në një treg të njohur për standarde të larta dhe kërkesa të rrepta, të krijosh një biznes të bukurisë nuk është vetëm ambicie, është sfidë e pastër. Marigona Moe, estetiste, sipërmarrëse dhe krijuese e markës “LA MOÉ”, e ka kthyer këtë sfidë në histori inspirimi. Me një qasje të bazuar te natyraliteti, profesionalizmi dhe përkushtimi personal, ajo ka ndërtuar një emër që njihet e respektohet në komunitetin zviceran dhe më gjerë.

Në këtë intervistë ajo flet për rrugëtimin e saj, sfidat, vizionin dhe filozofinë që e udhëheq çdo ditë...

Cili ishte momenti që të shtyu të hapje qendrën tënde estetike në Zvicër?

- Ishte një kombinim i pasionit tim për bukurinë dhe i dëshirës për të sjellë një standard të ri shërbimi.

Kur erdha në Zvicër pashë një mungesë hapësirash ku profesionalizmi, higjiena dhe sinqeriteti ishin parësore. Aty e kuptova se ishte koha të krijoja diçka timen...

Duke parë sot rrugëtimin tënd, cili ka qenë vendimi më sfidues, por më i vlefshëm?

- Të investoja vetë çdo gjë, kohën, energjinë dhe kursimet pa asnjë garanci suksesi. Ai guxim ishte vendimi më i vlefshëm, sepse hapi rrugë drejt çdo gjëje që kam sot.

Çfarë e bën qendrën tënde estetike të veçantë në tregun zviceran?

- Standardi, kujdesi dhe uniciteti.

Nuk ofroj vetëm trajtime, por përvoja.

Në “Marigona Moe” klientët marrin transparencë, profesionalizëm dhe rezultate natyrale e të sigurta.



Marigona Moe,

shqiptarja që u shndërrua në brend

Si e ruan të njëjtin nivel cilësie në çdo shërbim?

- Me shumë disiplinë dhe zero kompromis. Trajnohem vazhdimisht, punoj vetëm me pajisje moderne dhe nuk ofroj asgjë që nuk e përdor ose nuk e besoj plotësisht. Standardi është identiteti im.

Si e sheh zhvillimin e industrisë së estetikës në Zvicër dhe Kosovë dhe planet tua për të ardhmen?

- Të dyja po zhvillohen me ritme të ndryshme. Zvicra ka cilësi të padiskutueshme, Kosova ka energji dhe kreativitet. Unë dua t'i bashkoj këto dy botë. Në planet e mia janë zgjerimi, programet profesionale të trajnimit dhe lansimi i plotë i linjës sime kozmetike.

Cilat janë trajtimet më të kërkuara?

- Trajtimet që përmirësojnë lëkurën në mënyrë natyrale: peeling enzimor, hidratim i thellë, microneedling dhe procedura që rikthejnë shkëlqimin pa ndryshuar tiparet.

A mendon se sot ka tejkalim me filler dhe botox?

- Po, shpesh po. Qasja ime është minimaliste - më pak është më shumë. Bukuria duhet të përmirësohet, jo të humbasë identitetin.

Nga të lindi ideja për linjën tënde të kozmetikës dhe parfumeve?

- Nga boshllëku që pashë në treg. Shumë produkte nuk ishin as cilësore, as etike. Kështu lindi "LA MOÉ", një markë që përfaqëson luks, pastërti dhe rezultate reale.

Cili produkt është më i afërti me zemrën tënde?

- La Gommage dhe Lift Serum. I punova për muaj të tërë derisa i arrita formulat që doja. Janë produkte që i përdor

çdo ditë dhe u besoj pa rezervë.

Cila ka qenë sfida më e madhe gjatë ndërtimit të biznesit?

- Të ndërtoja gjithçka nga zero, pa rrugë të hapura. Çdo hap ishte mësim. Sfida më e madhe ishte të mos dorëzohesha edhe kur askush nuk besonte...

A ka pasur ndonjë moment të vështirë që sot e sheh si leksion?

- Shumë. Çdo gabim më mësoi vlerën e durimit, planifikimit dhe besimit të vetja. Pa ato sfida nuk do isha këtu.

Si ia del me presionin e të qenit njëkohësisht sipërmarrëse, kreative dhe menaxhere?

- Me shumë organizim dhe me zemër. Kur e do punën tënde presioni kthehet në motivim.

Kur filloi lidhja jote me qentë?

- Gjithmonë kam qenë e lidhur me ta. Qentë më japin qetësi dhe një ndjenjë të pastër dashurie. Janë pjesë e shpirtit tim...

Si ndikon ky pasion në përditshmërinë tënde?

- Më balancon. Edhe ditët më të ngarkuara zbuten me një moment me qentë e mi.

Kush është Marigona përtej biznesit, çfarë të motivon?

- Jam një grua që erdhi nga zero dhe punon me shpirt. Më motivon familja, pasioni dhe dëshira për të krijuar diçka me vlerë reale.

Çfarë këshille do i jepje një gruaje që dëshiron të nisë biznes në fushën e bukurisë, sidomos në një vend të huaj?

- Të jetë e guximshme, të besojë te vetja dhe të investojë në dije. Fillimi është i vështirë, por çdo gjë është e mundur kur nuk e tradhton vizionin tënd!



Valentina Nikqi, shqiptarja që bëri histori suksesi në Gjermani

Në një treg që ndryshon me shpejtësi dhe ku konkurrenca rritet çdo ditë, dallohen ata që punojnë me zemër, disiplinë dhe autenticitet.

Valentina Nikqi është një prej tyre. E ka ndërtuar karrierën hap pas hapi, duke u bazuar te profesionalizmi, përkushtimi dhe një lidhje e sinqertë me klientët.

Sot drejtimi që ka marrë puna në sallonin e saj "Beauty Salon Luna Cosmetic Academy" në Hameln të Gjermanisë është rezultat i një vizioni të qartë dhe i forcës për të ecur përpara edhe kur rruga nuk ka qenë e lehtë. Valentina në këtë intervistë rrëfen udhëtimin e saj, sfidat, momentet e triumfit dhe filozofinë që e udhëheqë çdo ditë në botën e bukurisë...



Nga e merr energjinë dhe motivimin?

- Energjia më vjen nga dëshira për të krijuar diçka që mbetet, diçka që i jep grave vetëbesim.

Sa herë shoh rezultatet e punës, më rikthehet motivimi i plotë.

Si po të ecë puna aktualisht?

- Puna po shkon në një drejtim shumë të mirë. Kërkesat janë rritur, ekipi është zgjeruar dhe funksionon në harmoni e profesionalizëm. Ndihej e lumtur me rritjen që po përjeton biznesi çdo ditë.

Jam, gjithashtu, duke u përgatitur për një hap të ri të rëndësishëm: Në vitin 2026 do të jem docente në një shkollë të shtetit për kozmetikë. Do të ndaj përvojën time me studentë të rinj - një arritje e madhe personale dhe një sfidë që mezi e pres.

Cili është suksesi që të ka përbushur më shumë?

- Më së shumti më përbush besimi i klientëve. Nuk është vetëm fakti që kthehen, por rritja e vazhdueshme që shoh çdo vit.

Edhe kërkesat nga VIP-at janë tregues i rëndësishëm, por, mbi të gjitha, është besimi i vazhdueshëm i çdo klienti që më bën të ndihem e suksesshme.

Cila ka qenë sfida më e madhe në fillim dhe si e ke kapërcyer?

- Sfidë kryesore ishte vendimi për të dalë nga zona e rehatisë dhe për të nisur diçka timen.

Kisha gjithmonë ëndërr të hapja një beauty salon, por frika ishte aty. Dhe, pikërisht atëherë Zoti më bekoj me dy binjakë, duke e bërë sfidën edhe më të madhe.

Megjithatë, u përqendrova, besova në veten dhe punova me disiplinë. Hap pas hapi ia dola...

Si ndryshon tregu i bukurisë jashtë vendit nga ai në Kosovë?

- Në thelb, tregu i bukurisë është i ngjashëm kudo. Ajo që kam mësuar jashtë vendit është rëndësia e profesionalizmit të vazhdueshëm: certifikimet, përditësimi me teknikat e reja dhe komunikimi i qartë me klientët. Por, dua të theksoj: Kosova ka shumë artiste të afta dhe me suksese të mëdha...

Çfarë të dallon në qasjen tënde ndaj klientëve?

- Unë nuk ofroj vetëm një shërbim - ofroj një eksperiencë. I dëgjoj me vëmendje, i këshilloj sipas nevojës dhe çdo vizitë përpigë me ta bëj të personalizuar. Nuk bëj dallime, qoftë kliente e zakonshme, VIP apo për videoklip. Për secilin jap maksimumin. Kjo ka ndërtuar besim dhe lidhje të singertë.

Si e mban biznesin unik në një treg të ngopur?

- Duke u fokusuar te vetja, jo te konkurrenca. Krijoj stilin tim, investoj në trajnim dhe pajisje profesionale dhe ndërtoj një atmosferë që pasqyron cilësi.

Cilat shërbime janë më të suksesshme dhe pse?

- Sot beauty është një lloj luks, një investim për mirëqenie dhe vetëbesim. Trajtimet e fytyrës, microblading, lazeri, head spa, makeup-i, secila prej tyre ka klientët e vet. Disa kërkojnë rezultate afatgjatë, disa kërkojnë luks, disa kërkojnë theksim natyral të bukurisë. E, ajo që i bashkon është dëshira për t'u ndier mirë.

Këshilla për një grua të re që nisë biznes jashtë vendit?

- Mos e prit momentin perfekt. Fillo me atë që ke. Investo në dije dhe disiplinë.

Mos u frikëso të jesh ndryshe - këmbëngulja e bën ndryshimin.

Momenti kur je ndier "ia dola"?

- Kur klientet nisën të më rekomandonin vetë, pa kërkuar unë asgjë. Aty e kuptova që puna po fliste vetë.

Si balancohet puna me jetën personale?

- Me planifikim dhe me kufij të qartë. Dua që dita ime të mos jetë vetëm punë, por të ketë edhe momente qetësie që më rikthejnë energjinë.

Kush ka qenë mbështetja jote më e madhe?

- Familja. Bashkëshorti dhe prindërit e mi kanë qenë shtylla ime. Më kanë mbështetur në çdo hap, edhe kur unë dyshoja. Mbështetja e tyre ka qenë thelbësore.

Si kujdesesh për veten kur lodhja fizike dhe emocionale bëhen pjesë e përditshmërisë?

- Filloj gjithçka me pushim dhe kohë cilësore me familjen. Këto momente më japin ekuilibrin që më duhet. I lejoj vetes edhe qetësi e reflektim sa herë ndiej nevojën...

Cila është rutina e bukurisë që nuk e anashkalon kurrë?

- Pastrimi, hidratimi dhe SPF-i janë baza të pandashme. Pastaj, trajtimet profesionale mujore mbajnë lëkurën të freskët dhe të shëndetshme. Unë jam për bukurinë natyrale. Më bën përshtypje kur shoh vajza shumë të reja që nisin me ndërhyrje të panevojshme. Fytyra ka pamjen e vet, mjafton kujdesi i duhur...

Çfarë të bën të lumtur në fund të ditës?

- Gjërat e vogla me ndikim të madh: një koment pozitiv, energjia e mirë, një ditë produktive. Lumturia ime vjen nga bindja se kam punuar me zemër dhe kam dhënë maksimumin.



Argjira Osmanaj Gjyliqi, gruaja që u bë sukses i gjallë

Emri i saj është i rrallë, historia e saj personale e veçantë dhe energjia që sjell në çdo hap të biznesit është e papërshkrueshme. Argjira Osmanaj-Gjyliqi nuk është, thjesht, pronare e studios "Hairlezz" në Zvicër e Kosovë, ajo është shprehje e guximit, e pasionit dhe e përkushtimit ndaj cilësisë. Nga eksperiencat në diasporë te krijimi i një ambienti ku profesionalizmi dhe respekti për klientin janë parësorë, rrugëtimi i saj tregon se si vizioni dhe vendosmëria mund t'i transformojnë sfidat në histori suksesi...



Emri yt është shumë i veçantë. A ka një histori pas tij?

- Po, ka një histori të bukur. Mami kishte lexuar për princeshën Argjiro nga Gjirokastra dhe e pëlqen aq sa ma lë emrin mua. Dhe, me kohën ky emër i rrallë u bë pjesë e identitetit tim: i fortë, i veçantë dhe me rrënjë.

Si do e përshkruaje rrugëtimin tënd nga diaspora deri te bizneset në Kosovë me tri fjali?

- U rrita mes dy realiteteve: strukturës së diasporës dhe mallëngjimit që gjithmonë më kthente te Kosova. Përvoja jashtë më dha disiplinë dhe qëndrueshmëri. Bizneset në Kosovë erdhën natyrshëm, si reflektim i guximit dhe dëshirës për të krijuar diçka timen.

Kur e kuptove se do t'i hyje fuqishëm botës së biznesit?

- Kur pashë që idetë e mia jepnin rezultate edhe si eksperimente të vogla. Aty e kuptova se nuk isha njeri i kufizuar brenda një zyre. Thashë me vete: "Ti mundesh shumë më tepër."

Cili ishte momenti që të shtyu të hapje një studio lazeri?

- Më lodhnin standardet e ulëta që shihja. Jam njeri i korrektesisë dhe pastërtisë dhe më vinte keq kur klientet trajtoheshin pa kujdes. Vendimi ishte i qartë: "Do ta bëj vetë dhe do ta bëj më mirë!"

Sa ndryshe është të menaxhosh një biznes në Zvicër krahasuar me Kosovën?

- Zvicra është e rregullt dhe sistematike, Kosova është më fleksibile, por me surpriza. Të dyja më kanë mësuar shumë: njëra disiplinë të hekurt, tjetra kreativitet dhe durim.

Cili është sekreti i suksesit të studios tënde?

- Standardet e larta dhe transparenca. Nuk premtoj gjëra që nuk i mbaj. Kam investuar në pajisje cilësore, trajnim dhe komunikim të drejtë. Klientet e ndiejnë këtë dhe rikthehen vetë.

Çfarë përfaqëson "Hairlezz" për ty?

- Është qetësi, pastërti dhe respekt për trupin e gruas. Dua që klientja të



- I shikoj të dyja, por i filtroj.
Trendet më japin frymëzim, klientet më japin drejtim. Balancimi i tyre sjell sukses...

Kur merr vendime të rëndësishme, a je më intuitive apo analitike?

- Jam miks, por intuita shpesh ka zërin më të fortë. Analizoj, por në fund i besoj ndjesisë sime dhe, zakonisht, del e saktë.

Nëse dita jote do të përshkruhej me një ngjyrë, cila do të ishte?

- Një e gjelbër e ngrohtë, ngjyrë e qetësisë, fokusit dhe rritjes si energjia ime dhe brendi im...



Cili është komenti më i papritur nga një kliente?

- Një ditë një kliente më tha: "Gjira, ti je si terapistë – vetëm diploma të mungon!".
Qesha shumë, por e vërteta është që ndonjëherë ashtu ndjehem.

Si relaksohesh pas një dite të gjatë me punë?

- Me familjen time. Aty e gjej qetësinë. Pastaj, zhytja në një serial sci-fi është "arratisja" ime perfekte.

A ke një zakon që të mban pozitive kur dita nuk të shkon si duhet?

- Po. Falënderoj veten për një gjë që e kam bërë mirë, qoftë edhe të vogël. Më rikujton që progresi nuk ka nevojë të jetë perfekt që të jetë progres.



Çfarë do t'i thoshe vetes së para 10 vjetëve?

- Beso më shumë në veten.
Mos prit, mos kërko aprovim.
Vepro.
Gabimet do të bëhen historitë që nesër do t'i përqafosh me buzëqeshje.

Çfarë këshille do i jepje një vajze të re që ëndërron të hapë biznesin e saj?

- Të mos pres momentin ideal, sepse nuk ekziston.

Të fillojë me atë që ka, të mësojë gjatë rrugës dhe të mos trembet nga dështimi.

Dështimi është provë që të ecësh përpara, jo arsye për t'u ndalur.

Nderim Neziri

ndihet e sigurt, e respektuar dhe pa stres sa herë që vjen te ne...

Si e ruan besnikërinë e klientëve?

- Duke i trajtuar si njerëz, jo si numra. I dëgjoj, i informoj dhe nuk u shes

asgjë të panevojshme.
Ku ka respekt - ka besnikëri.

A ndjek trende ndërkombëtare apo udhëhiqesh nga kërkesat e klientëve?

Flasin femrat e reja për shtatzëninë e papritur

Keni mbetur shtatzënë dhe nuk keni si të lindni. Ndoshta ende nuk jeni martuar apo nuk keni krijuar lidhje të shëndoshë. Dhe, turr në ordinancën mjekësore... Ndoshta është më mirë të mendoni se si ta lindni fëmijën, edhe pse për ju, natyrisht, do të jetë një barrë e rëndë. Si do të vepronit ju, po t'u ndodhë një gjë e tillë? Për këtë çështje biseduam me disa femra të reja, të cilat edhe kanë pasur rastin të hamenden me këtë çështje...

SHKURTA, 30 VJEÇE, PRISHTINË: NUK DOJA TA LINDJA, TASH E DUA SHUMË!

- I kam dy fëmijë si molla. Burri im dëshironte edhe fëmijë të tjerë, por unë nuk isha e gatshme për gjëra të tilla. Por, nganjëherë, gjërat nuk shkojnë ashtu si dëshiron ti vetë. Mbeta me barrë për së treti herë. Isha kategorike të abortoja, sepse nuk mund t'i merrja me mend edhe një herë gjithë ato dhembje të mëdha... Në anën tjetër, po të lindja fëmijën, më rrezikohej edhe vendi i punës, meqë firma ku punoja nuk do më jepte pushim. Por, burri nuk më la të abortoja dhe vendosëm bashkë - le të del ku të del... Mirëpo, pas lindjes së fëmijës fillova ta doja, madje më shumë se dy fëmijët e parë, për çudi...

FITI, 34 VJEÇE, FERIZAJ: NUK E HEQ FRYTIN TIM ASSESI...

- Jam shtatzënë qe katër muaj. Është fëmija im i tretë. Kur mbeta shtatzënë për së treti herë,

thashë me vete çfarë të bëja: ta lind apo jo...

Shkova të bisedoja me gjinekologun tim. I tregova se kisha plogështi të madhe dhe nuk dija si do e vazhdoja shtatzëninë. E ai, në vend që të më jepte kohë të mendohem, më tha: "Ndoshta është mirë të abortosh, sepse kjo plogështi që ke është jashtë çdo norme dhe shëndeti yt mund të përkeqësohet edhe më shumë". Thënë të drejtën, fjalët e tij më irrituan dhe vendosa ta mbaja frytin tim, qoftë edhe me sakrificë jete... E di se nuk do e kem lehtë, sidomos kur dihet se i kam edhe dy fëmijë të tjerë të vegjël, por më mirë kështu sesa të bëj krim.

BERTA, 37 VJEÇE, PEJË: MA JEP FËMIJËN MUA!

- Kurrë në jetën time nuk kam qenë në pozitë më të vështirë sesa kur kam mbetur shtatzënë. Ishim ende pa u martuar dhe nuk ishte bash e qartë e ardhmja jonë. Ai jetonte në Suedi dhe pushimet i kalonim bashkë dhe hiçgjë më shumë. Por, ndodhi dhe nuk dija si të veproja... Ç'të bëja: të vendosja për lindjen apo heqjen e një krijese njerëzore që sapo

kishte filluar?

Net të tëra i kalova pa gjumë...

Në ëndërr më dilte një shoqe imja, e cila, edhe pse kishte katër vjet e martuar, ende nuk kishte fëmijë...

Më thoshte: "Linde fëmijën, ma jep mua!". Në anën tjetër, më rrinin para sysh pamjet nga filmat turk ku femra të reja abortonin, shkak i dashurive të dështuara. Gjithë ato tmerre që përjetonin...

"Do lindi fëmijën dhe le të del ku të del", i thashë vetes.

Por, deshi fati që kur i tregova të dashurit tim se isha shtatzënë, më befasoi. Më tha: "Mrekulli, pra, do të bëhemi prindër!".

E, fjalët e tij ma shëruan zemrën...

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Jeta ka të papritura. Siç ka lumturi ka edhe vuajtje.

Por, edhe vuajtjet kanë një fund.

Andaj, sado që të vuani, çdo gjë tejkalohet...

Sepse, siç tha edhe Shkurta nga Prishtina, mu foshnjën që donte ta abortonte, kur i lindi e donte më shumë se dy fëmijët e parë!

Diturie Haxhaj

COURTYARD[®]
BY MARRIOTT

Prishtina

COURTYARD

BY MARRIOTT

courtyardprishtina.com

 [/courtyardprishtina](https://www.instagram.com/courtyardprishtina)



Pse sot s'ka burra si dikur?

Nuk ka pasur kurrë më shumë ndarje të çifteve bashkëshortore në Kosovë se sa që ka sot! Kjo që po ndodh në Kosovë është një turp që nuk justifikohet me fjalë...

Mund të tingëllojë utopike e vërteta se dikur në fshat kanë qarë i madh e i vogël kur është ndarë një çift...

"Pse dhe si erdhi te ndarja?", ka pyetur i madh e i vogël, duke qarë edhe nëse nuk e ka lidhur asgjë me çiftin familjarisht. Sepse, ka pasur vlerë jeta, ka pasur solidaritet.

Ka pasur fytyrë e burrëri...

Nuk ke mundur t'ia përzësh askujt vajzën pasi të jesh fejuar a martuar.

Burrat dikur thoshin: "Gruaja dihet për çka lëshohet. Dhe, kur lëshohet – kërcet pushka!"

Kur ka ndodhur një ndarje është marrë burrëria me të dhe e kanë shtruar problemin në odë, duke pleqëruar burrat.

E, sot?

Fill pasi fejohen e merr me vete i fejuari të fejuarën në shtëpi dhe e mbanë me javë e muaj të tërë, kurse pas një zënke të vogël ndahen, kinse nuk qenkan për njëri-tjetrin! Dhe, askush nuk merret me ta!

Pra, e mbanë të fejuarën sa të dojë dhe e lë kur ia do qejfi!

E, po të kishte burrëri si dikur, nuk do të ndodhnin gjëra të tilla...

Dikur kanë pyetur nga i ka dajallarët djali a vajza, kurse sot as që pyet kush për këto gjëra, sepse është krijuar vetëdija se mjafton të duhen ata dhe të shpallen burrë e grua...

PSE DIKUR

KA PASUR BURRËRI?

Dikur ka pasur burrëri dhe burrat janë flijuar për shumëçka që i ka takuar kodit moral dhe etikës njerëzore.

Në Prekaz të Drenicës kishin pas hyrë harambashët serbë dhe i kishin maltretuar e plaçkitur shqiptarët nëpër shtëpia. Kishin hyrë edhe në një shtëpi që ishte fqinje me shtëpinë e Ahmet Delisë, që i këndohet kënga.

Ahmet Delia i dëgjon britmat dhe i urdhëron djemtë t'i kapin sëpatat dhe ta mbrojnë fqinjin.

Kështu, kishte pësuar edhe vetë familja e Ahmet Delisë, por duke mos u pajtuar me nënshtrim, edhe pse dhuna nuk kishte ndodhur në familjen e tij.

Burrëri kishte pas lënë edhe Selman Kadria, që e ka përmendoren në hyrje të

fshatit Cërcë të Istogut, kur e kishte vlarë Miliç Kërstën, i cili i maltretonte banorët shqiptarë në fshat dhe në fshatrat përreth. Ai kishte shtënë me manzere në Miliçin, duke e lënë të vdekur në vend dhe duke pësuar dhe vetë nga daja i tij, që kishte bashkëpunuar me çetnikët në Istog.

SOT DEVIJIMI

I BURRËRISË

NIS NGA FËMIJËRIA!

Sot ende pa nisur fazën e shkollimit, fëmijët dinë të shajnë dhe të ofendojnë me të gjitha format ofenduese.

Por, edhe ata që shkojnë në shkollë shajnë! E, sharja nuk i bën përshtypje palës tjetër që i drejtohet!

Shtrohet pyetja: Pse sot nuk qon peshë sharja?!

Sepse, nuk i qon shumë peshë as nëna e as motra atij që i shahet dhe se ka degraduar jeta familjare aq shumë sa shajë kë të duash dhe si të duash...

Keq, a?

B. Bajrami

Revolucion në
DOBËSIM
Worldwide franchise



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë.
Rrugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë.
Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm.
Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përmbushur ëndrrat e tyre.



Ti shkoje nuse, unë prapa blirit **të shikoja ty!**

PËR TY...

Ti, që je hyjnore, e di më së miri se këto fjalë janë për ty, princeshën time...
Atë ditë që shkove nuse nga sytë e mi rrodhën pika loti.
As lulet nuk do qelin më...
As fluturat nuk do fluturojnë më...
E kisha parë një ëndërr që më sugjestionoi në një realitet. Kush do kishte menduar se do ishte po kjo ditë, dita e asaj ëndërr të hidhur?!
Ishte ditë me vapë kur një çupë, me fustan të blertë, po e shikonte "portretin" tim në një tubim ekspozues.
Ditët ecnin e ajo falte përditë e më shumë dashuri...
Në sytë e mi lindi një kohë e re.
Rilindi jeta edhe një herë, mendova me vete.
Por, sot ike heshtazi.
Do të qeshësh para dikujt, duke e fshehur dikë tjetër në zemër.
Ëndrra më kishte kapluar nën mundimin e kësaj dashurie të hidhur, kur sot do të shkoje ti, në shtëpinë tënde të re...

SHIKIMI TINZAR...

Ditën e mirë, flutura ime!
Kur të dalësh nga porta e shtëpisë sate, do

më kesh para vetes.

Mos harro ta ngritësh kokën! Më ke premtuar se do më shikosh aty ku do jem unë, te bliri i qytetit!

Do të ketë shumë njerëz, do të ketë shumë dasmorë që do të përqafohen për ty, në ditën tënde më të lumtur.

A ka ndryshuar diçka në këtë ditë apo më ke harruar?!

Sot do të perëndojë dielli pas kaq vitesh, e ti në kokë do e

mbash vellon e bardhë si bora.

A do të duket e bukur nata dhe a do të jetë nata jote më e lumtur?

Para meje rri një gotë verë, te kafeneja e dikurshme, te parku i qytetit. Një zonjë me fëmijën përdore erdhi dhe u ulë pranë tavolinës, nën hijen e blirit.

E njoha fytyrën e saj... Ishte fytyra jote...

Kemi pirë shumë verë bashkë në këtë vend, por ti paske nisur të plakësh...

E cakërojmë nga një gotë verë për plakjen tënde dhe për zemrën time të plasur...

Në çast nisën të më rrjedhin lotët...

A të kujtohen lotët e mi kur u ndeshën për herë të parë me sytë e tu?

Gëzuar!

S.M.

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android



BELIEVE IN NEW YEAR OFFER



START THE YEAR IN A BEAUTIFUL **SEA-VIEW ROOM**

Enjoy a warm welcome at reception.

Find a special Santa's gift waiting in your room.

31.12.2025

LUXURY SPA ACCESS
at Zen Spa

NEW YEAR'S EVE GALA DINNER
at Mandarin Restaurant

FIREWORKS SHOW
at Resort

EXCLUSIVE PARTY
at Lime Lounge

**ticket-only access - 3000ALL*

TEST YOUR LUCK
at Marina Casino

01.01.2026

NEW YEAR'S BREAKFAST
at Mandarin Restaurant

FIRST BRUNCH OF THE YEAR
at Lime Lounge

MARINA CINEMA
at Conference Hall

22.200 ALL / pax

Start Planing your Festive Experience
+355696041000 info@marinabay.al | www.marinabay.al

Flirti, zjarri tundues, mes biologjisë dhe moralit

NORIK UKA



Midis biologjisë dhe moralit: pse marrëdhënia jashtëmartesore nuk është vetëm flirt dhe çfarë ka të bëjë me fëmijërinë dhe psikologjinë tonë.

Studimet e konfirmojnë se rreth nëntëdhjetë për qind e njerëzve mendojnë se marrëdhënia jashtëmartesore është e pamoralshme dhe rreth gjatëdhjetë e pesë për qind thonë se nuk do ta falnin kurrë një partner që ka një marrëdhënie jashtëmartesore. Por realiteti është tjetër. Në një të katërtën e marrëdhënieve, megjithatë, ndodh një marrëdhënie jashtëmartesore. Pra, ajo që besojmë se nuk duhet bërë dhe ajo që bëjmë, shpesh nuk përputhen.

Pse ndodh kjo? Për ta kuptuar, duhet të dalim nga klishetë. Marrëdhënia jashtëmartesore nuk është thjesht një akt fizik, një flirt, një numër më shumë. Shumë shpesh ajo është një histori emocionale dhe psikologjike që fillon shumë përpara se të ndodhë marrëdhënia jashtëmartesore. Dhe kjo vlen jo vetëm për marrëdhënien jashtëmartesore bashkëshortore, por për çdo lloj tradhtie njerëzore. Biologjia flet një gjuhë të ftohtë për tradhtinë. Trupi ynë është i ndërtuar thjesht për t'u shumuar, bile na arsyeton në këtë mëkat sa që referon se ne nuk jemi monogamë, por poligamë. Procesi evolucionar tregon diçka tjetër. Njerëzit kanë mbijetuar vetëm sepse kanë pasur lidhje të qëndrueshme. Pra, prioriteti për t'u lidhur në çift është e thellë në ne. Por po aq e lashtë është edhe tjetra, kureshtja, pasioni dhe adrenalina për diçka të re. Atëherë shtrohet pyetja: nga këndvështrimi i biologjisë dhe fiziologjisë, a jemi vetëm Homo sapiens, apo ndonjëherë sillemi edhe si një lloj "hormon sapiens", të drejtuar nga impulset tona?

Shumë e qartë është se biologjia nuk njeht moral.

Ajo synon të ofrojë kushte për mbijetesën dhe riprodhimin. Moralit, rregullat dhe besnikërinë i sjellim ne si qenie sociale, përmes familjes, fesë dhe traditës. Por mua më shumë më intereson roli i psikologjisë në këtë fenomen emocional dhe kontradiktë.

Kur flas me klientët që kanë pasur ose janë në marrëdhënie jashtëmartesore, rrallë dëgjoj fjalë thjesht ndoqa instinktit, apo epshi më mashtroi. Shumë më shpesh dëgjoj fjalë ndjeja nevojën të ndihesa gjallë. Doja dikush të më shikonte prapë si grua ose burrë, të kisha vëmendjen e tjetrit, të kisha afirmimet pa kushte. Më dukej sikur si burrë apo si grua isha zhdukur, isha vetëm prind, punëtor, qenie që funksionon. Pra, marrëdhënia jashtëmartesore shpesh është simptomë, jo arsye, një pasojë e mungesës së vëmendjes, dëshirës dhe mirënjohjes. Një pasojë e një njeriu që nuk di më kush është, përtej rolit që luan.

Si të krijojmë lidhje të sinqerta dhe të qëndrueshme në martesë është një proces i thellë emocional. Edhe doracak më i mirë nuk të vlen, nëse mungon themeli: siguria, besimi dhe pranimiti i ndërsjellë. Procesi i një marrëdhënieje te ne njerëzit fillon qysh në krevatin e fëmijërisë, te lotët e parë, te duart që të morën apo të lanë. Në psikologji flitet për stil lidhjeje. Nëse si fëmijë përjeton interaksion kur qaj, dikush vjen, më merr, kur kam frikë, dikush më mban e më përqafton, nuk jam i tepërt dhe mjaftoj, atëherë krijohet mësimi i brendshëm se lidhja është e sigurt. Ky quhet stil i sigurt lidhjeje. Nëse përjeton interaksion nuk e di a vjen njeri, ndonjëherë po, ndonjëherë jo, ndonjëherë më qetësojnë, më duan ndonjëherë më bërtasin, më injorojnë mësimi është se lidhja është e pasigurt. Kjo pasiguri pastaj shfaqet më vonë veçanërisht në partneritet dhe në dashuri.

Lidhjet e pasigurt zakonisht shfaqen në dy forma kryesore. E para është lidhja ankthioze, Të lutem, mos më lër. Këta njerëz mbajnë brenda një dilemë të vazhdueshme. A mos po më lë edhe ky, siç më kanë lënë më parë. Këta persona kërkojnë shumë afërsi, konfirmim, vëmendje. Kapen fort pas partnerit, pikërisht sepse kanë frikë ta humbin. Marrëdhënia jashtëmartesore këtu mund të shfaqet si një mënyrë për të qetësuar vetveten, bile ky ose kjo po më do, dikush tjetër po më sheh, pra unë vlej. Është një mënyrë e gabuar për t'i rregulluar vetes, apo fëmijës së brendshme, se unë nuk jam i pavlerë ose e pavlerë, edhe pse personi e di se po dëmton diçka të rëndësishme.

E dyta është lidhja shmangëse, mua nuk më duhet

askush. Këta njerëz shpesh kanë mësuar se kur tregoj dashuri, lëndohem, kur jam i gatshëm, më refuzojnë. Reagimi është që ata duken të ftohtë, të pavarur, të fortë. Afërsia i bën nervoz. Kur lidhja fillon të bëhet shumë e thellë, ata largohen me vrapë. Këtu marrëdhënia jashtëmartesore mund të jetë një mënyrë për të ruajtur distancën, nuk jam komplet brenda kësaj lidhjeje, kam një derë hapur diku tjetër, është frikë nga dorëzimi total.

Në kulturën shqiptare dashuria shumë shpesh është çështje familjare. Martesa nuk është vetëm mes dy vetëve, por mes dy shtëpive. Besnikëria shihet jo vetëm si vlerë personale, por si çështje nderi. Kjo sjell dy pasoja, turp të madh për marrëdhënien jashtëmartesore dhe pak hapësirë për të folur hapur. Nëse dikush futet në një marrëdhënie jashtëmartesore, nuk dëmtohet vetëm partneri, por njollon edhe familja. Kjo shpesh nuk vlen për gjininë mashkullore, sepse burri ende shihet si ai që është për shtatë gra. Veçanërisht për gratë, marrëdhënia jashtëmartesore, edhe vetëm e dyshuar, mund të jetë stigme për vite me radhë. Dhe sepse ka kaq shumë turp, askush nuk flet. Shpesh as burri e gruaja mes tyre. Familja mbyll sytë, shoqëria mbyll sytë e veshët por jo gojë! Prandaj marrëdhënia jashtëmartesore është bërë një sekret i hapur, të gjithë e dinë, askush nuk e emëron. Shumë e praktikojnë, askush nuk e pranon. Secili gjynahet e veta, por ne nuk duhet të harrojmë se, përveç dëshirës për t'u nënkuqur sepse vetëm një jetë kemi, kemi edhe përgjegjësi për ata që i sollëm në jetë. Ndërkohë, fëmijët rriten në një atmosferë ku ata e ndjejnë tensionin, ftohtësinë, të pashprehurën, por askush nuk u shpjegon asgjë. Një fëmijë që rritet mes sekretit dhe turpit mund të mësojë se për gjërat e vërteta nuk flitet, ndjenjat fshihen, konfliktet kamufllohen. Dhe pikërisht kjo e bën më të vështirë që, si i rritur, të flasë hapur me partnerin ose partnerin. Dhe rrethi vicioz vazhdon.

A duhet ta justifikojmë marrëdhënien jashtëmartesore apo ta kuptojmë si një sinjal alarmi. Unë mendoj se ky alarm është më shumë subjektiv sesa objektiv. Kjo nuk heq përgjegjësinë nga ai ose ajo që hyn në një marrëdhënie jashtëmartesore, por hap një derë për reflektim, në mënyrë që i njëjti skenar të mos përsëritet, në këtë ose në një lidhje tjetër.

Në një kulturë si e jona, ku nderi dhe turpi kanë kaq peshë, guximi i vërtetë nuk është të durosh gjithçka, as të fshehësh gjithçka, por të flasësh para se të jetë vonë. Të thuash, diçka mes nesh nuk po shkon, nuk ndihem më i dëshiruar ose e dëshiruar, kam frikë se po afrohem me dikë tjetër. Jo sepse është moderne, por sepse vetëm aty fillon të kanalizohet atë që po të mundon.

Sepse para se të tradhtojë dikush tjetrin, shumë shpesh ka tradhtuar veten, nevojat e veta, ndjenjat e veta, të vërtetën e vet.

Dhe ndoshta, për ta ruajtur familjen si institucion, duhet të çlirojmë së pari veten nga lakmia, materializmi, ekstremet e modernizimit apo feminizmit të keqkuptuar dhe të përforcojmë thelbin, dashurinë, ndjeshmërinë, dinjitetin, komunikimin dhe sinqeritetin, së pari ndaj vetes. Të rrisim breza që nuk janë të etur për marrëdhënie jashtëmartesore, por që dinë të etur me përgjegjësi. Biologjia ka rregullat e saj, por njeriu ka një dhuratë që asnjë krijesë tjetër nuk e ka: vetëdijen dhe vullnetin për të zgjedhur rrugën e virtutit, për të qenë njeri me përgjegjësi.



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkendije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirsig

NJË EKSPERIENCË EKSKLUZIVE

në zemër të Prishtinës së Re...

www.cimaks.com



E kam emrin mashkull e mos e paça!

*Deri tash u martova
dy herë, por me asnjërën nuk u rehatova!
Pse?*

Isha djalë i pashëm dhe i takoja një familje të pasur dukagjinase. Në rininë time familja vendosi t'më martonte, kuptohet, sipas traditave të kohës, por duke respektuar edhe pëlqimin tim. Më fejuan me një vajzë të bukur, e cila edhe ajo ishte e një familjeje të pasur dhe të njohur në anën tonë. Pas një viti vendosëm të martohemi. Nga gëzimi që kishin prindërit e mi bënë dasmë të madhe.

MARTESA E PARË - PA SUKSES!

Kur krushqit e sollën nusen, në oborr filluan defet nga magjupet që i kishin siguruar për aheng, e bashkë me to edhe këngët e vajzave, derisa ra terri.

Pasi që krushqit hëngrën darkë, filluan të shpërndareshin, kurse unë nga lodhja as që mund të qëndroja ulur e lëre më në këmbë, siç e donte zakoni. Pas darke djali i axhës më grushtoi dhe më shtyri të hyja në dhomën ku ndodhej nusja. Nata e parë ishte pa sukses. Por, kështu ishte edhe nata e dytë, e treta e me radhë, kur edhe e humba besimin në vetvete. Kështu, me gruan e parë vazhduam rrafsh tre vjet dhe, më në fund, ajo vetë kërkoi ta liroja dhe ashtu u bë...

EDHE MARTESA E DYTË - SI E PARA!

Një vit pas ndarjes nga gruaja e parë familja ma gjeti një grua tjetër. Nuk kisha si të kundërshtoja, meqë asnjëherë në familje nuk e kisha hapur

problemin tim. Dhe, erdhi edhe dita e dasmës. Me kërkesën time nuk bëmë dasmë, por shkuan familja ime dhe dajallarët e mi dhe e morën nusen me dy vetura dhe e sollën në shtëpinë tonë. Edhe atë natë, kur hyra dhëndër për të dytën herë, tërë nata shkoi vetëm me përqafile e ledhatime, puthje e shtrëngime... Nejse, thashë me vete, ndoshta natën tjetër do kryej punë... Por, fatkeqësisht, as natën e dytë e as netëve të tjera nuk arrita t'i kryeja "detyrat e shtëpisë"... E, tash, kur edhe i kam bërë bukur do vjet, ende më brengos fakti se e mora në qafë gruan e dytë që me kohë nuk e lirova të bënte jetën e saj... Keq, a?

Dukagjinasi

KOMPLEKSI AFARISTO- BANESOR



Këngëtaren e njohur e kisha dashnore

Ka qenë një kohë kur biznesi më ecte mirë dhe nuk di as vetë sa femra të bukura i kam pasur rreth vetes: këngëtare, fotomodele... Jo pse kam qenë i bukur, porse kisha para në xhep. E tash, që më nuk e kam atë pasuri që e kisha dikur, kam mbetur pa dashnore, madje edhe pa grua...

Më shumë se gjysmën e jetës e kam kaluar në Zvicër dhe me punë arrita të krijoja kapital të mirë.

Por, kurrë nuk arrita të martohem. Jo se nuk kam pasur oferta, mirëpo nuk arrija ta bindja veten se cila nga femrat që kam pasur rreth vetes mund të jetë gruaja ime.

SI U NJOHA ME KËNGËTAREN?

Kurrë s'e kam qarë kokën për të kaluarën e gruas me të cilën do të bëja kurorë.

Unë as sot e kësaj dite nuk e di biografinë e plotë të këngëtares me të cilën i kalova dy vjet bashkë, e që më nuk është me mua, meqë patëm shumë mospajtime dhe u ndamë me kohë.

"Është këngëtare e mirë, por nganjëherë ngatërrohet me shumë burra", më tha pronari i lokalit ku ajo këndonte aso kohe.

Ajo ishte tërheqëse aq sa kur e pash për herë të parë duke kënduar, thashë: "Secili mashkull që ka para në xhep nuk i lë pa i shpenzuar për të!".

E, unë as që kisha menduar se, pikërisht, ajo femër që e konsideroja këngëtare të talentuar një ditë do të bëhej dashnorja ime.

SI E PËRVETËSOVA?

Një mbrëmje, teksa ajo këndonte në skenë, shoja e saj erdhi te tavolina ime dhe u ul pranë meje.

Pa i thënë asgjë më tha se a dëshiroja të pija kafe me këngëtaren të cilën e shikoja me kureshtje...

"Po, si jo?!", i thashë shpejt e shpejt. Kur ajo përfundoi me këngë, erdhi te tavolina ime.

Ajo u interesua të dinte gjithçka për mua dhe kur i thashë se kam biznes në Zvicër,

as që i interesonte tjetër.

Pas mbrëmjes u ngjitëm në katin e dytë të motelit ku ajo këndonte.

Dhe, prej asaj mbrëmje jemi takuar sa herë që vija në Kosovë apo vinte ajo te unë në Zvicër rrafsh dy vjet.

Ndërkohë, filloi t'i rritej mendja, sepse për para më nuk hiqte.

POSA BËRI PARA MA KTHEU SHPINËN!

U ndamë dy vjet pas njohjes sonë.

E tash, edhe pse i kam bërë bukur do vjet, as që më shkon mendja ta kem për grua ndonjë femër, duke u frikësuar se secila posa ta arrijë qëllimin ta kthen shpinën... Sidoqoftë, mburrem me veten time, sepse atë që shpesh e shoh në televizor duke kënduar, dikur e kisha dashnore.

R.

A portrait of a woman with dark, wavy hair, wearing a black sleeveless top. She is sitting on a white chair, resting her chin on her right hand and her left hand on the chair's backrest. She is wearing gold jewelry, including a watch and a bracelet. The background is a plain, light-colored wall.

BOOM

Adelina Milazimi,

shqiptarja që frymëzon
dhe udhëheq
drejt suksesit

Adelina Milazimi, shqiptarja që frymëzon dhe udhëheq drejt suksesit

"Të jetosh larg vendlindjes nuk është vetëm një lëvizje fizike, është një udhëtim i brendshëm, një sfidë që formëson karakterin dhe mënyrën se si e sheh botën". Ky është rrëfimi i një gruaje që e ka kthyer përvojën e saj në një mundësi për të fuqizuar të tjerët. Adelina Milazimi nëpërmjet "Albanian Legendary", po e transformon mënyrën se si shqiptarët mësojnë, ndërtojnë brand personal dhe zhvillojnë aftësi profesionale, duke krijuar një qendër referimi për edukim dhe rritje personale brenda dhe jashtë vendit.

Si do e përshkruanit veten nëse takoni dikë për herë të parë?

- Jam një person që beson te fuqia e rritjes personale dhe potenciali i secilit individ. Më pëlqen të dëgjoj, të kuptoj dhe të punoj me njerëz. Jam energjike, kureshtarë dhe gjithmonë e hapur ndaj ndryshimit. Vlerësoj disiplinën, punën e ndershme dhe një mentalitet që zhvillohet çdo ditë. Gjatë punës përpiqem të krijoj një hapësirë ku njeriu ndihet i sigurt për të eksploruar dhe për të zbuluar vlerën e tij.

Cila është historia juaj e shkurtër: Nga je, si u zhvendosët në diasporë dhe çfarë u ka formësuar më shumë?

- Jam nga Kosova, me një rini të mbushur me vlera familjare, përgjegjësi dhe punë të pastër. Zhvendosja në diasporë nuk ishte vetëm një lëvizje gjeografike - ishte një etapë e re me sfida, mësimë dhe transformime të thella. Duhej të filloja nga zero, të ndërtoja rrjet të ri dhe të adaptohesha me kulturë dhe mënyra të ndryshme të të punuarit. Këto përvoja më kanë bërë më të fortë, më të matur dhe më empatike.

Si të lindi ideja për t'u marrë me trajnime dhe punë me njerëzit?

- Ideja nisi nga dëshira për të krijuar diçka ndryshe dhe për të pasur liri financiare. Pas dy vitesh eksperimentimi, kjo u shndërrua në bashkëpunim me një ekspert të

fushës, duke krijuar "Albanian Legendary", një iniciativë unike në tregun shqiptar që sjell qasje të reja në edukim, mentorim dhe zhvillim personal.

Dhe, ajo që filloi si ide personale u kthye në një projekt me ndikim të gjerë.

Cila ishte sfida më e madhe jashtë Kosovës?

- Sfida më e madhe ishte ndërtimi i kredibilitetit dhe besimit në një ambient të panjohur.

Nuk kisha rrjet paraprak dhe as reputacion, por kisha përkushtim dhe këmbëngulje. Mësova të adaptohesha me mënyra të reja komunikimi dhe ritëm pune të ndryshëm. Dhe, pikërisht këto sfida më mësuan fleksibilitet dhe rëndësinë e punës së palodhur deri në rezultate të dukshme.

Si ka ndikuar përvoja jashtë vendit në mënyrën se si punoni me klientët?

- Ka dhënë një kuptim më të thellë për frikën, dyshimet dhe mundësitë që sjell emigrimi.

Sot punoj me shumë empati, duke dëgjuar secilin histori me kujdes dhe duke ia përshtatur strategjinë sipas individit. Kjo krijon ndryshim real dhe jo vetëm motivim afatshkurtër.

Kur flisni për mindset, çfarë ka më shumë peshë për ju: Disiplina, motivimi apo strategjia?

- Motivimi ndez fillimin, por është disiplina që i çon gjërat deri në fund.



Mindset-i fitues është kombinim i qëndrueshmërisë dhe strategjisë, është zakoni i përditshëm për ta bërë punën edhe kur nuk ka entuziazëm.

Cili është keqkuptimi më i zakonshëm për zhvillimin personal?

- Shumë njerëz mendojnë se zhvillimi personal është vetëm pozitivitet dhe frymëzim.

Në realitet, është punë e brendshme, reflektim dhe ndryshim zakonesh. Ka ditë të vështira dhe momente introspektive, por ndryshimi që sjell është i thellë dhe afatgjatë.

A keni pasur një përvojë që ndryshoi mënyrën se si e shihni suksesin?

- Po. Koha jashtë vendit më ka mësuar se suksesi nuk matet me një moment triumfi, por me rrugëtimin drejt tij. Sukses janë hapat e vegjël, ditët e punës së palodhur dhe besimi që ndërtohet në vetvete. Sot sukses për mua është rritja e vazhdueshme, jo vetëm arritja.

Çfarë u mungon më shumë njerëzve kur ndërtojnë brand personal?

- U mungon qartësia, vetëbesimi dhe guximi për të treguar historinë e tyre. Brandi personal është identitet, autenticitet dhe aftësi për të qëndruar unik dhe fillon aty ku dikush kupton vlerën e vet dhe guxon ta shprehë pa frikë.

Marketingu i sotëm kërkon më shumë autencitet apo aftësi teknike?

- Marketingu modern kërkon autenticitet më shumë se teknikë. Teknika është mjet, por lidhja me publikun krijohet përmes transparencës, historive reale dhe vlerave të ndara. Njerëzit ndiejnë kur dikush është i vërtetë.

Cili është transformimi më i bukur që keni

parë te një pjesëmarrës i programeve tuaja?

- Magjike është të shohësh individë që fillojnë me pasiguri dhe largohen me vetësiguri, qartësi dhe rezultate të prekshme.

Të shohësh dikë që dikur nuk guxonte të fliste për veten e sot prezanton brandin me krenari, është momenti më emocionues i punës sime.

Si e shihni veten dhe punën tuaj pas 5 vjetësh?

- "Albanian Legendary" synon të konsolidohet si sistemi më modern i edukimit digjital shqiptar, duke ofruar platforma për mësim, zhvillim profesional dhe sipërmarrje. Synojmë të krijojmë një akademi elitare që i ndihmon individët të kalojnë nga tradita drejt një epoqe të re zhvillimi profesional dhe lirie financiare.

Cili është projekti që ua ngacmon mendjen për të ardhmen?

- Po ndërtojmë sistemin e parë shqiptar të zhvillimit personal, profesional dhe digjital. Qëllimi është të fuqizojmë individë dhe biznese me aftësi të matshme, mentalitet sipërmarrës dhe mjete digjitale, duke krijuar transformim personal dhe ekonomik me plan dhe disiplinë.

Diçka e re që po vjen?

- Po finalizojmë një fazë të re të projektit edukativ, që synon të krijojë një hapësirë të unifikuar për mësim modern, rritje profesionale dhe mbështetje sipërmarrëse si brenda vendit, ashtu edhe në diasporë.

Jeta private?

- Rëndësi i jap balancës ndërmjet punës, familjes dhe kohës personale. Por, mirëqenia emocionale dhe mendore është prioritet, sepse vetëm duke qenë mirë me veten mund të kontribuosh realisht për të tjerët.

Nderim Neziri

Histori pa u lindur unë...

Krejt kjo histori brenda këtyre rreshtave kishte ndodhur shumë vite pa u lindur unë. Ishin fjalë të përditshme të babait që zgjohej në mëngjes, duke kënduar këngë për Mujin e Halilin dhe më pas për t'u zhgrehur në vajë...

Halla ime dhe babai im ishin fëmijë të vetëm, si vëlla e motër. Ishin rritur jetimë pa nënë.

Dhe, me kohë halla ishte martuar, kurse edhe babai pas disa vjetësh, meqë 10 vjet ishte më i ri se ajo.

Por, rahatia e tyre ishte prishur me të marrë lajmin se motra e tij do të shkonte në Turqi.

Babai ishte munduar ta bindte familjen e saj të qëndronte, të mos e lëshonte vendlindjen, por ata kishin vendosur të ikin, duke mos parë dritë në fund të tunelit.

Dhe, në mëngjesin e një pranvere babai kishte shkuar te e motra për ta përcjellë. Sidoqoftë, e tëra që kishte mbetur mes tyre ishte amaneti i saj lënë vëllai të saj që ta vizitonte shtëpinë e saj sa më shpesh dhe ta mbante "në këmbë" sa të ishte e mundur.

Ajo ikë përtej shtatë deteve, siç thuhet në letërsinë popullore, pas të cilëve do ta gjente një tokë, ku do niste një jetë të re në një shtëpi të vogël, që do e ndërtonin shpejt e shpejt, para se t'i zinte dimri, ndërkohë që la në Kosovë një kullë shekullore, tokë e pasuri tjetër.

Ndërkaq, me vete mori vetëm shpresën se

do të kthehej një ditë në vendlindje...

Andaj, vetëm ajo shpresë që strehohej në fund të zemrës ishte një motiv për të shkuar, madje edhe në fund të botës, e për të jetuar me ndjenjën e kthimit një ditë kur të ndalonin zullumet e serbëve ndaj shqiptarëve të Kosovës.

TAKIMI PAS 43 VJETËSH NË TURQI

Kishin kaluar shumë vite nga ndarja e hallës sime me vëllanë e vet.

Dhe, pas 43 vjetësh babai im nisët për në Turqi me autobusin që shkonte në Stamboll.

Krejt çka dinte për motrën e vet ishte se e motra e tij jetonte diku në Turqi...

Pas katër ditësh udhëtim, babai kishte arritur në vendbanimin e quajtur Kajnaxhe në Turqi.

Dhe, pyetje pas pyetje e fjalë pas fjale, i kishte rënë në gjurmë.

"E dini ku jetojnë Dërgutët e Mymleqetit?", e kishte pyetur një grua që dinte shqip.

"Po", i ishte përgjigjur ajo.

"E njihni në atë familje një plakë nga Kosova?", i kishte thënë ai.

"Po", i kishte thënë ajo.

Dhe, hap pas hapi, babai im me atë grua shqiptare ishin gjendur në derën e hallës sime.

Por, kur hyjnë brenda e motra e tij nuk e njeh, sepse kishin kaluar 43 vjet pa u parë...

"Mirë se erdhe, por nuk po të njoh!", i thotë ajo.

"Jam Rexha", i ishte përgjigjur babai im. Në çast asaj i bie të fiktë...

Dhe, kur vjen në vete përqafohen për-mallshëm si motra me vëlla më...

PO TË VJEN ERA KOSOVË!

Babai pas ca ditësh e kishte pyetur motrën se cili ishte burimi i jetës së tyre familjare. E motra i kishte thënë se mbjellja e orizit dhe e patateve ishin burimet kryesore të jetës së tyre.

Dhe, në ditët në vijim babai im me motër të tij dhe nipa e mbesa ia mësyjnë arave të tyre, e që ndodheshin jo larg shtëpisë, pranë një lumi...

"Unë, vëlla, deri më tash kurrë nuk e kam ndie erën e tokës. E, tash po e ndjej atë, sepse ty po të vjen erë tokë Kosove!", i thotë me lot në sy e motra.

S. Murturi

SHËRIMI I HEMORROIDEVE me laser

- ☀ Pa **dhimbje**
- ☀ Pa **gjakderdhje**
- ☀ Procedurë **e shpejtë**
- ☀ Rikthim në punë **pas tri ditësh**

Departamenti i Proktologjisë drejtohet nga kirurgët specialistë **Dr. Valon Zejnullahu dhe Dr. Arben Haliti**, nën mbikëqyrjen e **Dr. Thomas Deska**.

Në spitalin Anaderm trajtimet për hemorroide, fistula, fisura dhe sinus pilonidal **kryhen ekskluzivisht me teknologji laser**, duke përdorur teknika të avancuara moderne.



Burri më tradhton, unë e dua edhe më shumë!

Jam 31 vjeçe, jetoj në Mitrovicë. Ka dy vjet që jam martuar. Unë dhe bashkëshorti im kemi katër vjet që njihemi, por kur u martuam kishim vetëm tetë muaj që ishim në lidhje bashkë.

Asnjëherë tim burrë nuk e kam kundërshtuar dhe në disa raste isha dakord edhe me të, sepse ne ende jetojmë në banesë me qira dhe nuk jemi mirë ekonomikisht. Dukej se çdo gjë shkonte mirë, të paktën në pamje të jashtme, por nuk ishte aspak kështu. Dy muaj më parë zbulova se më kishte tradhtuar dhe kishte fjetur me një tjetër femër.

E dëgjova duke folur me një shok të tij, i cili e pyeste si kishin shkuar gjërat me femrën tjetër dhe deri ku kishin shkuar. Ky i tregonte me mburrje se kishte marrë nga ajo çfarë kishte dashur...

BURRI IM NIS TË QAJË SI FËMIJË PARA MEJE!

U trondita dhe nuk dija çfarë të bëja. I kërkoja shpjegim, por më gënjeu dhe filloi të qajë para meje.

Ai nuk e dinte çfarë kisha dëgjuar unë dhe u përpoq t'më bindte se nuk bëhej fjalë për femër tjetër, por për një kliente,

me të cilën kompania ku bashkëshorti im punon kishte bërë kontratë. I thashë se e kisha dëgjuar teksa fliste dhe e pranoi, por nisi të qajë dhe më tha se më donte shumë dhe se ajo që kishte ndodhur nuk do përsëritej.

Më tha se kishte gabuar dhe se ishte përfshirë nga vrulli e kishte rënë në kurthin e asaj femre, e cila e kishte provokuar. Pas dy jave zënkash dhe debatesh praktikisht u ndamë, por ai vazhdonte t'më kërkonte falje, duke më premtuar se nuk do të ndodhë më kurrë një tradhti e tillë. Madje, përdori dhe dëshirën time për të pasur një fëmijë dhe më tha se së shpejti do të kemi gjithçka që kemi dashur, madje dhe fëmijën...

IA DHASHË MUNDËSINË E DYTË

Vendosa t'ia jap një mundësi të dytë, por muajin që kaloi zbulova se po më gënjeje përsëri. Si përfundim zbulova se ka

shkuar edhe me një femër tjetër në shtrat. Ndërkohë, unë ende jam në banesë duke i shërbyer, duke i qëndruar pranë, duke u çmendur pas tij dhe duke dashur të sjellë në jetë një fëmijë nga ai...

Si ka mundësi që jam katandisur kështu? Edhe vetë nuk arrij të besoj se gjatë këtyre dy vjetëve martesë unë nuk kam kuptuar asgjë dhe ai është shtirur me mua, ka ardhur e më ka përqafuar, ndërsa një ditë më parë ka qenë me dikë tjetër... Megjithëse tani i di të gjitha, nuk arrij dot ta urrej.

Përkundrazi, e dua gjithnjë e më shumë! Gjatë këtyre ditëve që kam zbuluar se çfarë ka bërë pas shpinës sime nuk kam pushuar së qari, ndërsa vazhdoj ta lejoj t'më puth dhe jo vetëm kaq...

Nuk e di se ku ka përfunduar dinjiteti im, krenaria ime?!

Edhe pse ma ka copëtuar zemrën dhe më ka zhgënjyer pa fund, nuk arrij të ndahem prej tij dhe nuk mund të jetoj pa të...

Drenusha



for your
Special moments

G GLAMOUR

Për rezervime na kontaktoni në Instagram: [glamourevnts.pr](https://www.instagram.com/glamourevnts.pr)



Shkronja e parë e emrit tregon si je në shtrat

Vlen për të dy gjinitë, edhe për meshkuj edhe për femra...

EMRAT QË FILLOJNË ME A

Nuk je romantik në mënyrë të veçantë, por je interesant në aksion.

Je gjithmonë i zënë. Me ty ajo që shihet është ajo që fitohet, sepse je ashtu siç prezantohesh. Nuk ke durim të flirtosh dhe nuk të bezdis fakti kur dikush është i turpshëm, simpatik ose eksitues. Kur bëhet fjalë për seks ajo që ka rëndësi është aksioni dhe jo truket sekrete.

EMRAT QË FILLOJNË ME B

Të kënaqin gjërat romantike me verë dhe darkë bashkë.

Je i lumtur kur merr dhuratë si shenjë dashurie nga partneri yt. Të pëlqen të jesh i përkëdhelur dhe di të përkëdhelësh partnerin. Je shumë i rezervuar, por para se të bësh dashuri manifeston një shprehi butësie dhe dashuri të ngrohtë.

EMRAT QË FILLOJNË ME C

Je person shumë i shoqërueshëm dhe është e rëndësishme për ty të krijosh shoqëri.

Ke nevojë për afërsi dhe të jesh i lidhur me dikë.

Je i gatshëm të bisedosh me një partner seksual para dhe pas. Do që objekti i dashurisë tënde të jetë mirë dhe të jetë shoqërisht i pranuar.

Je ekspert për t'i kontrolluar dëshirat tua në seks.

EMRAT QË FILLOJNË ME D

Kur vendos në kokë diçka, bën çdo gjë për të arritur qëllimet tua.

Nuk jep përgjigje lehtë, por je me edukatë. Je lartësisht seksual, pasional, i drejtë dhe i thellë, ndonjëherë je posesiv dhe xheloz. Seksi për ty është një kënaqësi që të bën të ndihesh i plotësuar.

EMRAT QË FILLOJNË ME E

Nevoja jote e madhe është për të folur.

Nëse personi i takimit tënd nuk është një dëgjues i mirë ke probleme për t'u shoqëruar me të. Një person duhet të të stimulojë ose nuk do të të interesojë seksualisht. Ke nevojë për shok, për dashnor dhe për partner krevati.

Të pëlqen të flirtosh.

EMRAT QË FILLOJNË ME F

Je idealist dhe romantik, e ngre dashnorin tënd në pedestal.

Të pëlqen të flirtosh, por nëse dashurohesh je shumë i drejtë. Je sensual, seksual dhe në mënyrë private je pasional. Publikisht tregohesh ekstravagant. Ke lindur romantik.

Skenat e dashurive dramatike janë fantazitë tua të preferuara.

EMRAT QË FILLOJNË ME G

Ji i bezdisshëm, duke kërkuar perfekten.

I përgjigjesh një dashnori i cili ka një intelekt të njëjtë ose superior me tëndin. Je shumë sensual dhe di si të arrish pikën maksimale të stimulimit erotik, sepse kërkon të paarrtshmen. Mund të jesh tepër aktiv seksualisht kur gjen kohë. Mund të kesh vështirësi emocionale kur përfundon një marrëdhënie, por nuk mbyllësh seksualisht.

EMRAT QË FILLOJNË ME H

Kërkon një partner që të realizojë reputacionin tënd.

Mund të jesh shumë bujar me dashnorin tënd, sidomos kur arrin të biesh në dashuri. Para se të dashurohesh mendon

dhe je i rrëshqitshëm për t'iu dedikuar këtyre gjërave dhe zakonet e tua të takimeve janë të njëjta.

EMRAT QË FILLOJNË ME I

Ke nevojë të madhe për të qenë i dashuruar, i vlerësuar edhe në punën tënde. Vlerëson kënaqësitë ekstreme në seks, sensualitetin dhe kënaqësitë e mishit. Kërkon dashnore që di se çfarë bën. Je jo i qetë dhe i saktë në dëshirat tua. Je i gatshëm për të eksperimentuar forma të reja seksuale. Mërzitësh lehtë dhe për këtë ke nevojë për aventura seksuale dhe ndryshime.

EMRAT QË FILLOJNË ME J

Mund të jesh shumë romantik ose i lidhur me bukurinë e dashurisë. Të kesh një partner është gjëja më e rëndësishme për ty. Je i lirë në shprehjen e dashurisë dhe je i gatshëm të kapësh mundësitë, duke provuar eksperiencë të reja me partnerin. Kërkon dashuri, ëmbëlsi dhe mbrëmje me qirinj.

EMRAT QË FILLOJNË ME K

Seksualisht je i mrekullueshëm, por duhet t'i konsiderosh më mirë vlerat e personave dhe veçanërisht të tuat. Nuk do ishte keq që ky motivim të të frymëzojë për t'u kultivuar pak më shumë, duke ndërruar imazhin dhe përshtypjen që projekton në fillim me personat që takon dhe më shumë me ata që të tërheqin.

EMRAT QË FILLOJNË ME L

Je shumë romantik, idealist dhe disa herë beson se dashuria do të thotë vuajtje. Të tërheqin personat që kanë probleme të pazakonshme. E sheh veten si shpëtimtari i dashnORES tënde. Je i singertë, pasional, ekstrem në seks dhe ëndërrimtar. Nuk ke nevojë për ndihmë për të rënë në dashuri. Fantazon me filma dhe revista.

EMRAT QË FILLOJNË ME M

Je emocional dhe i thellë. Kur e sheh veten të rrëmbyer nga një lidhje, i dedikohesh totalisht asaj. Asgjë s'të ndalon, nuk njuh pengesa. Beson krejtësisht të dikush që është i njëjtë, pasional dhe intens. Beson në lirinë totale seksuale dhe kërkon gjithmonë të provosh gjithçka. Energjia jote seksuale është e palodhshme dhe të pëlqen të mbrosh partnerin.

EMRAT QË FILLOJNË ME N

Ke nevojë për stimulime konstante, sepse ke lindur me këtë dëshirë. Mund të mbash më shumë se një marrëdhënie në të njëjtën kohë me shumë

lehtësi. Nuk mund të heshtësh mendjen tënde dhe flet kur bën dashuri. Me kokën dhe fantazinë tënde mund të kesh historitë më të mëdha për ty. Je fantazues në seks aq sa partneri shpesh nuk mund të të ndjekë në fantazitë tua.

EMRAT QË FILLOJNË ME O

Je interesant në aktivitetet seksuale dhe tregon sekretet e tua më të turpshme dhe dëshirat tua. Mund të kesh lehtësisht periudha të qeta, por je pasional, i pakënaqur duke kërkuar të njëjtat cilësi te partneri. Seksi është një marrëdhënie serioze, i cili kërkon thellësi mendore dhe ndryshueshmëri, ke aftësi të provosh çdo gjë ose çdo person.

EMRAT QË FILLOJNË ME P

Je shumë i ndërgjegjshëm për gjërat tua primare shoqërore. Nuk do mendoje kurrë të bëje diçka që mund të dëmtojë imazhin ose reputacionin tënd, andaj do partner tërheqës. Është mjaft e çuditshme që e sheh partnerin tënd si një kundërshtar. Je seksualisht i lirë. Eksperimenton gjëra të reja në çdo fushë. Je shumë shoqëror dhe joshës, të pëlqen të flirtosh dhe ke nevojë të jesh i tërhequr.

EMRAT QË FILLOJNË ME Q

Ke nevojë për aktivitet konstant dhe stimulues. Ke një energji fizike të llahtarshme. Është shumë e vështirë për partnerin tënd të të ndjekë seksualisht, madje edhe në gjëra të tjera. Je dashnor entuziast dhe ke tendencë për të qenë i tërhequr nga njerëz të grupeve të tjera etnike. Ke nevojë për romantizëm, zemër, lule dhe biseda që të ndezin.

EMRAT QË FILLOJNË ME R

Nuk je rrëmujaxhi. Ke nevojë për dikë që mund të mbajë pagën me ty dhe për dikë që të ketë një intuitë dhe zgjuarsiri të mirë. Ndizesh shpejt si me një që ka mendje të madhe, po ashtu edhe me një që ka trup të bukur. Pra, tërheqja fizike është shumë e rëndësishme për ty. Je shumë seksi, por në krevat shërben më shumë si profesor.

EMRAT QË FILLOJNË ME S

Ke sekrete, autokontroll dhe je i turpshëm. Je shumë seksi, sensual dhe pasional, por shpesh nuk ia lejon vetes. Vetëm në intimitetin privat del në pah kjo anë e natyrës tënde. Një të gjitha truket për t'u marrë vesh. Mund të luash çdo rol dhe e merr jetën tënde dashurore seriozisht.

EMRAT QË FILLOJNË ME T

Je shumë i ndjeshëm, i rezervuar dhe seksualisht disi pasiv. Të pëlqejnë partneret që marrin iniciativën. Muzika, dritat e errëta dhe mendimet romantike janë gjërat që të ndezin. Fantazon, por nuk dashurohesh lehtë. Kur je i dashuruar je romantik, idealist, sentimental.

EMRAT QË FILLOJNË ME U

Je entuziast dhe ke prime kur dashurohesh. Por, kur nuk je i dashuruar me ndonjë person je i dashuruar me dashurinë, duke kërkuar gjithmonë dikë që ta adhurosh. I sheh gjërat romantike si një sfidë. Je një vagabond dhe ke nevojë për aventura, eksitime dhe liri. Të pëlqen të bësh dhurata për të parë partnerin tënd të ndihet mirë. Mënyra jote e të bërit seks është e fortë dhe me shumë dëshirë, një kënaqësi momentale.

EMRAT QË FILLOJNË ME V

Je individualist dhe ke nevojë për hapësirën tënde, për lirinë tënde. Shpreson derisa dikush të të dojë. Ndjën nevojën për të qenë në kokën e personit tjetër për të parë se ç'mendon. Të tërheqin tipat egocentrik. I përgjigjesh rrezikut, të pëlqejnë trilerët. Skenat lezbike të ndezin edhe kur nuk bën pjesë.

EMRAT QË FILLOJNË ME Y

Je seksual, sensual dhe shumë i pavarur. Nëse nuk mund t'i bësh gjërat në mënyrën tënde, atëherë i lë fare. U përgjigjesh stimulimeve fizike, të pëlqen të kalosh orë të tëra vetëm duke u prekur. Në çdo rast, nëse nuk mund të kalosh kohën duke punuar, i dedikohesh kënaqësive të mishit. Ke nevojë t'i provosh vetes dhe partnerit tënd se je dashnor i mirë. Do të ushqesh performancat tua dhe të jesh i hapur, duke stimuluar pjesët intime të partnerit. Në krevat je shoqëruar romantik dhe stimulues.

EMRAT QË FILLOJNË ME Z

Për ty të merresh vesh seksualisht me partnerin është në vend të parë, madje më parë se kënaqësia. Je krejtësisht i shqetësuar për karrierën tënde. Nëse nuk ke një pozitë të mirë ekonomike bie në dëshpërim, por je tip që nuk dorëzohesh lehtë. Mund të jesh shumë më tepër romantik sesa personi që keni pranë dhe ke aftësinë të kesh një sensualitet shumë të madh. Kur arrin të gjesh dashurinë, përkulesh para saj.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse burri im bërtet për çdo gjë?

Jam grua që jetoj në Zvicër. Jam 55 vjeçe. Kam probleme me burrë dhe nuk di ku e kanë bazën... Nuk kam guxim t'i bëjë asnjë pyetje. Ka kohë që nuk më do dhe po e shoh se më urren... Fëmijët janë rritur, jetojnë në banesat e veta... Çka sheh në rastin tonë?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Keni probleme të vjetra. Të paktën, keni probleme që 10 vjet dhe ato lidhen me ty, pikërisht... Tani jeni në kohë menopauze dhe durimi është kah u braktisë të dyve. Lodhja psikike e ka humbur durimin, kurse zemra ka mbetur me po ato probleme që i keni pasur edhe dikur... Të preferoj të bisedosh me fëmijët, që të jetosh me ta, derisa burrit t'i kalojë tensionimi, sepse mund të keni edhe situata të rrezikshme!

A të ndahem nga burri?

Jam një zonjë, 43-vjeçare, jetoj në Ferizaj. Jam martuar që disa vjet me

njeriun që e kam dashur vetë. Por, sjellja e tij ka bërë që herë pas herë tash ta urrej, aq sa kam ardhur në pikën të mos e dua. Sjellja e tij ka bërë që dashuria ndaj tij t'më kthehet në urrejtje...

Përgjigje:

Nuk u shoh bashkë në jetë. Jeni dy tipa të ndryshëm: ti tepër e butë, ai tepër i vrazhdë! Mos nxito me veprime, sepse çdo gjë e parakohshme është e dëmshme. Zoti i madhërishtëm e sjellë vetë momentin kur ju do të merrni vendimin e duhur.

Nuk kam fat në jetë...

Jam 27-vjeçare. E kam kryer fakultetin, por nuk kam arritur të punësohem askund. A ekziston fati dhe nëse ekziston, pse te unë nuk ka arritur akoma?

Përgjigje:

Fati ekziston. Ti, konkretisht, nuk je e pafat, por po të vjen fati. Fejohesh në muajin maj të vitit të ardhshëm. E, kah fundi i vitit të ardhshëm martoresh.

A kemi magji në familje?

Përsëritet e nderuara dhe respektuara magjistare, ta kemi lakmi që u ndihmon njerëzve dhe ua thua të vërtetën.

Kemi menduar se jemi familje pa probleme, por edhe te ne dolën ca të tilla.

Jemi vajza të pafejuara dhe kemi nevojë të ndihmohemi që të rehatohemi.

Të lutemi, na trego, çka po ndodhë në shtëpinë tonë dhe a kemi magji apo jemi pa fat?

"Vajzat me halle"

Përgjigje:

Para së gjithash, është problemi se në Kosovë ka ndodhur një ndryshim flagrant socio-psikologjik pas lufte. Është etapë kohe prej 25 vjetësh, që ka shkaktuar "tërmet" sociologjik, që ka disa përafrime me parimet e shteteve të BE-së dhe ajo frymë tash është edhe te ne, në Kosovë.



Kur është fjala për fejesë, mos prisni t'u vjen në derë mesiti si dikur dhe të kërkojë t'u bëjë ofertë.

Duhet familja të ketë mirëkuptimin ndaj jush që të angazhoheni vetë që ta gjeni fatin tuaj... Është e lejuar fetarisht dhe njerëzisht ta gjeni vetë fatin dhe të përgjigjeni ndaj vetvetes me atë që e siguron.

Por, shoh magji në shtëpinë tuaj. Ju e keni një tavan me një pullaz të lartë dhe kushdo që hipë le të kërkojë mbi trarin kryesor, kah përëndimi, një mbështjellje najloni të dyshimtë. Në të ka gjëra të magjive: thonj, flokë, gozhda dhe një fasulet me gjak. Hidhni sa më larg shtëpisë!



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP




@dentfix ks


+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC